



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 1 nëntor 2024
Nr. ref.: RK 2571/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI31/24

Parashtrues

Nuhi Metaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev.nr.320/23]
të 21 gushtit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nuhi Metaj nga fshati Krojmir, Komuna e Lipjanit (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar me autorizim nga Shpetim Sadiku, avokat nga Lipjani.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [Rev. nr. 320/23] të 21 gushtit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme).
3. Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 tetor 2023.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit, të garantuara me nenin 24 [Barazia para ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 32 [E Drejta për Mjetet juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E Drejta për Proces të Rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 shkurt 2024, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën e kishte dorëzuar në postë më 6 shkurt 2024.
7. Më 12 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [Nr.GJR. KI31/24] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci Gjyqtare raportuese, si dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI31/24] caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 11 mars 2024, Gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 19 mars 2024, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 19 mars 2024, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Lipjan lidhur me regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi dërgimin e fletëkthesës që dëshmon se kur e ka pranuar parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin e kontestuar.
11. Në të njëjtën ditë, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të saj.
12. Më 25 mars 2024, Gjykata pranoi fletëkthesën e kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan.

13. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Nga shkresat e lëndës rezulton se V.G në cilësinë e blerësit dhe parashtruesi i kërkesës në cilësinë e shitësit në gusht të vitit 1989, kanë lidhur kontratë gojore për shitblerjen e një pjese të paluajtshmërisë në sipërfaqe 0.05,00 ha, e evidentuar në fletën poseduese nr.401 ZK Topliqan. Këtë pronë të paluajtshme, V.G. si blerës nuk e kishte regjistruar ligjërisht në emër të tij. Në kohën kur u krijuan rrethanat për transferimin ligjor të pronës së blerë nga parashtruesi i kërkesës tek V.G., rezulton që V.G. dhe ish-bashkëshortja e tij N.G. në ndërkohë ishin ndarë, rrjedhimisht të dy ish-bashkëshortët kanë pretenduar se secili nga ta janë pronarë të asaj ngastre tokësore të blerë nga parashtruesi i kërkesës. Në një datë të paspecifikuar paditësit V.G. dhe N.G. (ish bashkëshortë në mes vete) kanë paraqitur padi të ndara në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Degën Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), kundër parashtruesit të kërkesës, për vërtetimin e pronësisë së paluajtshme - tokës - arë që i përkiste ngastrës kadastrale, nr. 139-5, e cila gjendet në vendin e quajtur "Urvishtë". Meqenëse paluajtshmëria është e njëjtë në të dy paditë, me qëllim të ekonomizimit të procedurës Gjykata Themelore ka bashkuar këto dy procedura me qëllim të zgjidhjes së kontestit me një vendim përfundimtar.
15. Më 20 mars 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.4040/14] ka vendosur si në vijim: *"I. APROVOHET padia e precizuar e paditësit V.G. nga f. Sllovi dhe VËRTETOHET se paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e posedimit me mirëbesim në pjesën e ngastrës kad. nr. 139-5, në sip. prej 0.05,00 ha, në, vendin e quajtur "Urvishte" me kulturë arë kl. e IV-të [...] dhe "II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e N.G.[...]," e cila sipas të dhënave nga dispozitivi i Aktgjykimit kishte kërkuar të drejtën pronësore mbi të njëjtën ngastër tokësore. Në fund të dispozitivit Gjykata Themelore kishte vendosur që "secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale".*
16. Gjykata Themelore kur aprovoi padinë e V.G. të paraqitur ndaj parashtruesit të kërkesës arsyetoi se *"V.G ka qenë mbajtës me mirëbesim më tepër se 20 vite pa u penguar nga askush nga dita e arritjes së marrëveshjes gojore e gjer më sot, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura dhe faktin e posedimit të paditësit, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi."* Ndërsa sa i përket padisë së paditëses N.G. padinë e së cilës Gjykata themelore në pikën II të dispozitivit të të njëjtit Aktgjykim e refuzoi si të pabazuar, në pjesën arsyetuese gjykata theksoi *"Gjykata i vlerësoj pretendimet e paditëses respektivisht të autorizuarit të sajë dhe e refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se e njëjta me asnjë provë paditësja nuk e ka argumentuar se e njëjta e ka blerë placin kontestues, ndërsa vetë dorëzimi i mjeteve, respektivisht i një shume të mjeteve nuk paraqet bazë për fitimin e pronësisë."*
17. Më 23 prill 2018, paditësi i parë V.G., i pakënaqur pjesërisht me Aktgjykimin [C.nr 404/14] të 20 marsit 2018 të Gjykatës Themelore, vetëm në pjesën e dispozitivit, ku çdo pale iu caktua të bartë shpenzimet e tyre procedurale, brenda afatit ligjor, paraqiti ankesë për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore. Gjithashtu, paditësi propozoi që shpenzimet e procedurës kontestimore t'i bartë parashtruesi i kërkesës në shumën gjithsej prej 3,199.60 euro.
18. Gjykata nga shkresat e lëndës dhe nga arsyetimi i parashtruesit të dhënë në kërkesën e parashtruar në gjykatë, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është ankuar kundër Aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Themelore.

19. Më 28 prill 2023, Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) nxori Aktgjykimin [Ac.nr.2364/2018], përmes të cilit aprovoi pjesërisht si të bazuar ankesën e paditësit të parë V.G. si dhe ndryshoi pikën III të Aktgjykimit [C.nr.404/14] të 20 marsit 2018 të Gjykatës Themelore, ashtu që detyroi parashtruesin e kërkesës që në cilësinë e të paditurit t'i paguajë paditësit V.G. shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15 ditëve nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Pjesa tjetër e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore mbeti e pandryshuar.
20. Parashtruesi i kërkesës pranoi Aktgjykimin e lartpërmendur të Gjykatës së Apelit më 31 maj 2023.
21. Më 16 qershor 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion kundër Aktgjykimit [Ac.nr.2364/2018] të 28 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit duke kërkuar që i njëjti Aktgjykim të anulohet, si dhe Aktgjykimi [C.nr.404/14], i datës 20 mars 2018, i Gjykatës Themelore, sa i përket pikës së III të dispozitivit lidhur me shpenzimet procedurale të vërtetohet.
22. Përmes revizionit, parashtruesi i kërkesës theksoi që i njëjti nuk mund të ngarkohet me shpenzime procedurale, për faktin se paditësit në cilësi të bashkëndërgjyqësve të pretenduar material, si ish-bashkëshortë janë konfrontuar se kush ka kontribuar në blerjen e ngastrës kontestuese gjatë bashkësisë martesore.
23. Më 21 gusht 2023, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin [Rev.nr.320/23], përmes së cilit hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit të kërkesës.
24. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme theksohet se duke u bazuar në nenin 218 të LPK-së, si dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 218 i ligjit bazik i cili përcakton: *"1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm, apo jo i plotë, hedhet poshtë me aktvendim të gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore. 2. Revizioni është i palejueshëm nëse: a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit; b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin ; c) nëse personi i cili e ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij; d) është paraqitur revizion kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet"*.
25. Gjykata Supreme në arsyetim gjithashtu ka theksuar *"me nenin 229, paragrafi i 3-të LPK-së, përcaktohet se; "Revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit mbi shpenzimet e procedurës"*.
26. Gjykata Supreme duke u thirrur në paragrafin 3 të nenit 229 të LPK-së, arriti në përfundim se Gjykata e Apelit ka vendosur vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës, ndërsa pjesa tjetër e Aktgjykimit të shkallës së parë, ka mbetur e pashqyrtuar prandaj në rastin konkret revizioni është i palejuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin [Rev. nr. 320/23] të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimin [Ac. nr. 2364/2018] të Gjykatës së Apelit, atij i janë shkëlur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me nenet 24 [Barazia para ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E Drejta për Proces të Rregullt) të KEDNJ-së.

28. Parashtruesi i kërkesës fillimisht thekson se “*në këtë Gjykatë paraqitet në cilësinë e të paditurit të cilit nga Gjykata e instancave me të ulëta i'u është mohuar e drejta për ushtrim të mjeteve juridike*”.
29. Lidhur me pretendimin për shkeljen e nenit 24, parashtruesi i kërkesës thekson “*Vendosja në këtë mënyrë nga Gjykata Supreme e Kosovës konsiston në shkelje dhe cenim të nenit 24 Barazia para Ligjit, duke i pamundësuar të paditurit mbrojtje ligjore te barabartë para ligjit pasi që në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese nuk merr për bazë dispozitat e nenin 455 të LPK-së, në të cilin nen decidivisht është paraparë se “Në qoftë se i padituri nuk i ka dhënë shkas padisë, nga shkak se e ka pohuar kërkesëpadinë dhe ka qenë i gatshëm ta përmbushë detyrimin e vet, paditësi duhet t'ia shpërblej të paditurit shpenzimet e procedurës*”.
30. Sa i përket nenit 31 të Kushtetutës lidhur me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se “*tërë arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është shabllon komplet i një lënde tjetër dhe nuk përmban asnjë shpjegim, arsye apo faktet vendimtare nga të cilat Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv*”.
31. Parashtruesi i kërkesës thekson se “*këto konstatime të Gjykatës së Apelit i legjitimon Gjykata Supreme e Kosovës me Aktvendimin e saj kur vendos që të hedhet poshtë si i palejuar revizioni i të paditurit*”. Vendosja e tillë nga Gjykata Supreme sipas parashtruesit të kërkesës “*konsiston në shkelje dhe cenim te nenit 24 Barazia para ligjit, duke i pamundësuar mbrojtje të barabartë ligjore të paditurit pasi që në mënyrë arbitrare dhe diskriminuese nuk merr për bazë dispozitat e nenit 455 të LPK..... dhe dispozitën e nenit 459.1...*”.
32. Parashtruesi thekson gjithashtu që ai nuk kishte interes për të kontestuar kërkesë padinë e paditësve, si dhe nuk kishte interes të ushtrojë mjetin juridik -ankesën ndaj aktgjykimit të shkallës së parë, pasi që sipas parashtruesit “*pika I dhe II e dispozitivit të këtij Aktgjykimi asgjë nuk ka qenë kontestuese, ndërsa lidhur me pikën III të diapozitivit të këtij Aktgjykimi nuk ka pasur ndonjë impakt pasi që gjykata ka vendosur që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale*”. Për këtë sipas parashtruesit ai “*ka paraqitur revizion kundër Aktgjykimit të shkallës së dytë, pasi që me këtë aktgjykim është ndryshuar pika e III e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë duke e ngarkuar të paditurin (parashtruesin) me shpenzimet procedurale*”. Me këto veprime të dy gjykatave sipas parashtruesit të kërkesës “*është privuar përjetësisht të kërkojë mbrojtje gjyqësore duke mos qenë i barabartë para ligjit, dhe duke iu cenuar e drejtat në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe duke ju cenuar e drejta në mjete juridike...*”.
33. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: (i) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 24 [Barazia para ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjetet Juridike], në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E Drejta për Proces të Rregullt) të KEDNJ-së; (ii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.2364/2018] të 28 prillit 2023, si dhe Aktvendimin Gjykatës Supreme [Rev.nr.320/23] të 21 gushtit 2023; dhe (iii) të kthejë Aktvendimin e Gjykatës Supreme për rivendosje.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

1. Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E Drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]"

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 229

229.3 Revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit mbi shpenzimet procedurale.

LIGJI NR. 04/L-118 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 11

Neni 218 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 218

- 1. Revizioni i paraqitur pas kohe, i palejueshëm apo jo i plotë, hudhet poshtë me aktvendim të Gjykatës së shkallës së parë pa mbajtur seancë gjyqësore.*
- 2. Revizioni është i palejueshëm nëse:*
 - a) e ka paraqitur personi i cili nuk është i autorizuar për paraqitjen e revizionit;*
 - b) revizionin e ka paraqitur personi i cili e ka tërhequr revizionin;*
 - c) nëse personi i cili ka paraqitur revizionin nuk ka interes për paraqitjen e tij;*
 - d) është paraqitur revizioni kundër aktgjykimit kundër të cilit sipas ligjit nuk mund të paraqitet.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

34. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
35. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]”

36. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev.nr.320/23] të 21 gushtit 2023 të Gjykatës Supreme pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit.
38. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet të parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
39. Gjykata po ashtu rikujton se parashtruesi duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi nuk mund të zgjasë afatet kohore të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, rastet e Gjykatës [KIo6/23](#), parashtrues *Hizri Haxhiu*, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2024, paragrafi 20; [KI112/19](#), parashtrues *Illir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 38; si dhe rastin e GJEDNJ-së, [Ferne kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).
40. Në këtë kontekst, lidhur me si më sipër, dhe për të përcaktuar nëse mjete i fundit i dorëzuar parashtruesit ishte efektiv në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev.nr.320/23] të 21 gushtit 2023 të Gjykatës Supreme, dhe Aktgjykimin [C.Nr.2364/2018] të 28 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, për të cilat pretendon se i kanë shkelur të drejtat kushtetuese pasi që me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit ishte vendosur që parashtruesi duhet të bartë shpenzimet e procedurës gjyqësore në procedurën në të cilën ai ka qenë palë e paditur. Parashtruesi thekson se me veprimet e të dy gjykatave ai “është privuar përjetësisht të kërkojë mbrojtje gjyqësore duke mos qenë i barabartë para ligjit, dhe duke iu cenuar

e drejtat në gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe duke ju cenuar e drejta në mjete juridike...”

41. Fillimisht, Gjykata në raport me çështjet e ngritura vëren se me Aktgjykimin [C.Nr.2364/2018] e 28 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, ishte vendosur përfundimisht lidhur me padinë e parashtruar kundrejt parashtruesit të kërkesës sikurse edhe me barrën e pagesës së shpenzimeve procedurale nga ana e tij, dhe se ai vendim gjyqësor ishte bërë i plotfuqishëm. Gjithashtu, Gjykata vëren se pjesa e dytë e arsytimit të Aktgjykimit [Ac.nr.2364/2018] të Gjykatës së Apelit përmban fakte dhe arsytim të një rasti tjetër dhe me palë të tjera, edhe pse në secilën faqe të Aktgjykimit shfaqet numri dhe data e njëjtë e aktgjykimit si në faqen e parë ku është vendosur dispozitivi, pra edhe në pjesën e dytë të arsytimit në Aktgjykimin [Ac.nr.2364/2018] e Gjykatës së Apelit.
42. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që parashtruesi i kërkesës Aktgjykimin [C.Nr.2364/2018] e Gjykatës së Apelit të 28 prillit 2023 e ka pranuar më 31 maj 2023, ndaj të cilit kishte parashtruar kërkesë për revizion.
43. Gjykata tutje vëren se me Aktvendimin [Rev.nr.320/23] e 21 gushtit 2023 të Gjykatës Supreme, revizioni i parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit i ishte hedhur poshtë si i palejuar për shkakun se Gjykata Supreme kishte vlerësuar se në përputhje me paragrafin 3 të nenit 229, të LPK nuk lejohet revizioni kundër vendimit për shpenzimet procedurale, duke mos trajtuar fare pretendimet e ngritura nga parashtruesi lidhur me bazueshmërinë e Revizionit, respektivisht kërkesën e parashtruesit që të mos bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, sepse sipas ligjit revizioni ishte i palejuar.
44. Gjykata konsideron se në këto rrethana, kërkesa për revizion kundër Aktgjykimit [C.Nr.2364/2018] të Gjykatës së Apelit nuk ishte mjet efektiv ligjor, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të ketë pritshmëri për sukses të këtij mjeti. Gjykata në parim, ka theksuar se në rastet kur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit në Gjykatën Supreme është i palejuar bazuar në ligjin e aplikueshëm, i njëjti nuk mund të përdoret për qëllime të llogaritjes së afatit katër (4) mujor dhe se si “vendim përfundimtar,” duhet të llogaritet vendimi i gjykatës përkatëse kundër të cilit është paraqitur mjeti i jashtëzakonshëm juridik i revizionit dhe i cili kontestohet para Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese [KI 135/16](#), parashtruesi: *Tomislav Jankovic dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, të 27 tetorit 2017, paragrafi. 25 dhe rastin [KI 81/17](#) parashtrues *Rapsina Muslija* Aktvendim për papranueshmëri i 11 prillit 2018, paragrafi 34).
45. Gjykata po ashtu thekson se GJEDNJ në rastin [Željko Knapić kundër Kroacisë](#) (vendim i GJEDNJ i 4 qershorit 2009) ka theksuar “*Gjykata vëren se kërkesat e parashikuara në nenin 35, paragrafi 1, që kanë të bëjnë me shterjen e mjeteve juridike të brendshme dhe periudhën gjashtëmujore, janë të ndërlidhura, sepse jo vetëm që janë të kombinuara në të njëjtin nen, por janë gjithashtu të përcaktuara në një fjali gramatikore interpretimi e së cilës nënkupton një marrëdhënie të tillë të ndërsjellë”.*
46. Rrjedhimisht, Gjykata bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në praktikën e saj gjyqësore duhet të shqyrtojë kriterin e mjetit të përdorur të ndërlidhur me kriterin e afatit të paraparë ligjor në kërkesën e ngritur para saj (shih, rastin e Gjykatës [KI240/19](#), parashtrues *Enver Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 marsit 2021, paragrafi 49).
47. Bazuar në si më lart, Gjykata konsideron se periudha 4 (katër) mujore fillon të ecë nga data e dorëzimit të vendimit përfundimtar i cili është rezultat i shterjes së mjeteve juridike të cilat janë adekuate dhe efektive për të siguruar kompensimin në lidhje me

çështjen e cila është objekt i ankesës (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Norkin kundër Rusisë*, parashtrës nr. 20156/11, Vendim për pranueshmëri, i 5 shkurtit 2013; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës Kushtetuese [KI23/21](#), parashtrues: *Rabit Fazliu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 qershorit 2021, paragrafi 41).

48. Përfundimisht në raport me si më sipër dhe duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, marrë parasysh faktin se mjete juridik i përdorur nga parashtruesi i kërkesës, cilësohet si mjet joefektiv dhe se vendimi përfundimtar i cili ka vendosur lidhur me çështjen kontestuese – shpenzimet procedurale në barrë të parashtruesit të kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [C.Nr.2364/2018] i 28 prill 2023, e të cilin parashtruesi i kërkesës e ka pranuar më 31 maj 2023, dhe që kërkesën në Gjykatën Kushtetuese parashtruesi e kishte dorëzuar në postë më 6 shkurt 2024, të cilën Gjykata e pranoi më 8 shkurt 2024, rezulton që kërkesa në Gjykatë është parashtruar jashtë afatit katër (4) mujor të paraparë me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) c të Rregullores së punës së Gjykatës. Rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë pretendimet e ngritura lidhur me shkeljet e pretenduara të së drejtës për barazi para ligjit dhe të drejtën për gjykim të drejtë në të gjitha elementet e saj.
49. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe në rregullin 34 (1) c të Rregullores së punës së Gjykatës.
50. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit është e papranueshme sepse është parashtruar jashtë afatit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) c të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 shtator 2024, njëzëri:

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani